

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	FOTO/ E akuzoi për përdhunim kur ishte 13 vjeçe, gruaja tërheq akuzat ndaj Jay-Z: "Nuk e kam takuar kurrë"
ADRESA	https://www.gazetatema.net/lifestyle/foto-e-akuzoi-per--kur-ishte-13-vjece-gruaja-terheq-akuzat-nd-i588352
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:06:37 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:00:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ed0d90d79cd500305f2ecf6b1b26fe70e09c140c33100f4edd68502ccdb00b2e
TEKSTI	c898683b8f6267ca309b76af5190b6ac3508ab5ab71005bc5e29f4647259c818
PAMJA	2e3b555a72d21650aa6b29e89124cf5788db215ed6c0e1c2426abe1804bd1ce7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	08a562d21ec4722a414e50e6e4a93559baae203fc87c24ef0bdf1179868ee656
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/08a562d21ec4722a414e50e6e4a93559baae203fc87c24ef0bdf1179868ee656>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie Von der Leyen nis turneun ne Ballkan - Presidentja e KE-se mberrin te merkuren per takime zyrtareInteligjenca Artuhciale hyn ne tregun imobiliar, shtepite nuk duken n fundit

FOTO/ E akuzoi për përdhunim kur ishte 13 vjeçe, gruaja tërheq akuzat ndaj Jay-Z: “Nuk e kam takuar kurrë”



25 Shtator 2026, 17:00Lifestyle TEMA



Gruaja që në vitin 2024 akuzoi Jay-Z për përdhunim kur ishte 13 vjeçe ka tërhequr zyrtarisht pretendimet ndaj reperit, duke deklaruar se ato ishin të pavërteta.

Në një deklaratë të re të depozituar në një gjykatë federale në Manhattan, gruaja, e identifikuar si “Jane Doe”, tha se Shawn “Jay-Z” Carter nuk e ka përdhunuar dhe se ajo nuk e ka takuar apo folur ndonjëherë me të.

Ajo deklaroi gjithashtu se nuk ka asnjë të vërtetë në pretendimet e saj të mëparshme dhe kërkoi falje për dëmin që ato i kanë shkaktuar reperit dhe familjes së tij. Sipas saj, nuk ka marrë dhe nuk i është premtuar asnjë pagesë për këtë deklaratë.

Gruaja kishte ngritur padinë fillimisht në vitin 2024, duke pretenduar se ishte sulmuar seksualisht në një festë pas MTV Video Music Awards të vitit 2000. Në padinë e ndryshuar më vonë u përfshi edhe Jay-Z, ndërsa Sean “Diddy” Combs ishte gjithashtu i paditur.

Jay-Z i kishte mohuar që në fillim akuzat. Paditësja e kishte tërhequr çështjen në shkurt 2025, pasi kishte pranuar se kishte mospërputhje në rrëfimin e saj. Më pas, reperi ngriti padi ndaj saj dhe avokatëve të saj.

Në deklaratën e fundit, gruaja pretendon se në vitin 2024 kishte parë një njoftim në Facebook që kërkonte persona me pretendime për sulme seksuale ndaj Sean Combs. Ajo tha se më pas u kontaktua nga një firmë avokatie dhe se padia u depozitua pa u kryer, sipas saj, verifikimi i mjaftueshëm i pretendimeve.

Avokati Tony Buzbee, i cili e përfaqësonte atë në çështjen fillestare, ka kundërshtuar këtë version. Ai tha se disa avokatë kishin folur me gruan përpara se ai të përfshihej në çështje dhe se ajo u kishte dhënë të njëjtin rrëfim.

Ndërkohë, çështja ligjore e Jay-Z ndaj avokatëve të saj vijon, ndërsa gruaja është hequr nga padia e tij.

Burimi: Rolling Stone



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Gati 30 vite pas vdekjes, pse libri për Princeshë Dianën po shkakton kaq shumë reagime?](#)

15:40 Lifestyle

["Duket si kameriere", veshja e Melania Trump kritikohet në rrjet pas takimit me Xi Jinping](#)

15:05 Lifestyle / 3 komente

["Dua të jem bodibilder deri sa të vdes"/ Japonezi 90-vjeçar stërvitet gjashtë ditë në javë dhe vazhdon të fitojë tituj](#)

14:19 Lifestyle

[Holanda ndryshon qëndrim, rikthehet në Eurovision pas bojkotit](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.